| 13  | Përgjigje në prapësim                                                                                                      | 18            |
| 14  | Urdhër për përfundim të procedurës përmblyesore nga përmblyesit privat                                                     | 63            |
| 15  | Seancë përgatitore                                                                                                         | 1             |
| 16  | Parashtrësia të dorëzuara në Gjykatën Themelore në Prishtinë                                                               | 3             |
| 17  | Kërkesë Dep. Financiar për pagesë të faturës së avokatit                                                                   | 1             |
| 18  | Numri i rasteve të përfunduara nga propozimet për përmblyesit (padi) të përmblyesit privat, sektori biznesor-institucionet | 24            |
| 19  | Numri i rasteve të përfunduara nga propozimet për përmblyesit (padi) të përmblyesit privat, sektori i amvisërisë           | 245           |
| 20  | Përgjigje në kërkesë DHKEK                                                                                                 | 1             |
| 24  | Pagesat e realizuara nga Gjykata Themelore                                                                                 | 0.00€         |
| 25  | Taksat e realizuara nga Gjykata Themelore                                                                                  | 0.00€         |
| 26  | Pagesat e realizuara nga përmblyesit privat në sektorin biznesor-institucione                                              | 56,421.16€    |
| 27  | Taksat e realizuara nga përmblyesit privat biznesor                                                                        | 1,395.95€     |
| 28  | Pagesat e realizuara nga përmblyesit privat në sektorin banesor- amvisëri                                                  | 94,778.31€    |
| 29  | Taksat e realizuara nga përmblyesit privat amvisëri-banesor                                                                | 10,215.07€    |
| 30  | Kamatat ndëshkuese të realizuara nga përmblyesit privat                                                                    | 0.00€         |
| 31  | Total pagesat e realizuara përmes Gjykatës dhe përmblyesëve privat, gjatë periudhës raportuese                             | 162,810.49€   |

## DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

Aktivitetet në Departamentin administrativ gjatë periudhës raportuese korrik-shtator 2025, në mënyrë të detajuar i paraqesim në vijim:

**Tabela 10.** Aktivitetet në Departamentin administrativ gjatë periudhës korrik-shtator 2025

| nr | Lloji i punëve                                                    | Vëllimi       | Përshkrimi                                                                                                                                                           |
|----|-------------------------------------------------------------------|---------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1  | Kontrata dhe aneks kontrata të protokoluara dhe vulosura në arkiv | 75            | 63 Kontrata dhe aneks kontrata të rregullta si dhe 12 kontrata të ndryshme                                                                                           |
| 2  | Shkresa                                                           | 13            | Shkresa të ndryshme                                                                                                                                                  |
| 3  | Kërkesa                                                           | 89            | Kërkesa të ndryshme                                                                                                                                                  |
| 4  | Vendime                                                           | 317           | Vendime të ndryshme                                                                                                                                                  |
| 5  | Njoftime                                                          | 18            | Njoftime të ndryshme                                                                                                                                                 |
| 6  | Vërtetime                                                         | 4             | Vërtetime të ndryshme                                                                                                                                                |
| 7  | Procesverbale                                                     | 18            | Të ndryshme                                                                                                                                                          |
| 8  | Autorizime                                                        | 3             | Të ndryshme                                                                                                                                                          |
| 9  | Raporte                                                           | 216           | Raporte pune, të ndryshme                                                                                                                                            |
| 10 | Puna e arkivës                                                    | Në vazhdimësi | Është arkivuar i tërë dokumentacioni i dërguar dhe i sjellë për arkivim                                                                                              |
| 11 | Llogaritja e pagave                                               | Në vazhdimësi | Janë përlogaritur pagat, shujtat mujore për korrik-shtator 2025 si dhe janë shpërndarë mbushjet telefonike për punëtorët e caktuar në listë                          |
| 12 | Sigurimi                                                          | Në vazhdimësi | Gjatë kësaj periudhe sigurimi ka kryer punët konform rregullave dhe përgjegjësi                                                                                      |
| 13 | Evidenca e punëtorëve                                             | Në vazhdimësi | Është mbajtur evidenca e të gjithë punëtorëve në hyrje- dalje                                                                                                        |
| 14 | Pastrimi i objekteve dhe oborrit                                  | Në vazhdimësi | Gjatë kësaj periudhe punëtorët e pastrimit kanë kryer punën me efikasitet dhe përgjegjësi. Është mbajtur pastërtia e të gjitha objekteve, zyreve dhe oborrit.        |
| 15 | Logjistika                                                        | Në vazhdimësi | Janë mirëmbajtur të gjitha automjetet, janë mbajtur evidencat e lëndëve djegëse veç e veç (total derivatet e hargjuara korrik-shtator 2025 janë 1,185.35 litra) etj. |

### Aktivitetet e realizuara nga Zyra e IT-së, gjatë periudhës raportuese korrik-shtator 2025:

- Janë mirëmbajtur të gjitha programet aplikative të nevojshme për "Termokos" Sh.A.;
- Ndërhyrje brenda SQL në server për përmirësim tek disa dokumente sipas kërkesave të faturimit (EXPERT PRO);
- Përditësim në versionin e ri tek të gjithë përdoruesit (EXPERT PRO); Ruajtja e shënimeve në bazë javore e databazës (EXPERT PRO);
- Mirëmbajtja, instalimi i EXPERT PRO dhe të gjitha plug-inëve përcjellëse, që janë të nevojshme për funksionimin e tij (EXPERT PRO);
- Mirëmbajtja e instalimi i MS Office me licenca ilegale;
- Instalime të ndryshme të programeve aplikative të nevojshme për kompaninë; Shtirje dhe mirëmbajtje konstante e rrjetit;
- Kontrollimi i kompjuterëve për virus përmes aplikacioneve antivirus e antimalware dhe përditësimi tyre;
- Mirëmbajtje harduerike tek 100 kompjuterë;
- Rregullimin e Microsoft Word, Excel dhe Outlook për mbi 100 përdorues;
- Rregullimi i printer/skaner tek përdoruesit;
- Instalim në kompjuterë i OS e Office dhe bartje të shënimeve.

## Kordinimi i ndërmarrjes me institucionet tjera

Në kuadër të mbikëqyrjes/monitorimit të aktiviteteve nga ZRRE dhe bashkëpunimit me institucionet tjera, gjatë periudhës raportuese korrik-shtator 2025, janë realizuar këto aktivitete:

### Raportet e dërguara në ZRRE:

- Raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore për NP "Termokos" Sh.A. për vitin 2024, nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
- Draft- raportet e plotësuar me të dhëna të parashikuara për sezonin 2025/2026 nga NP "Termokos" Sh.A., në kuadër të aplikimit për tarifa për sezonin 2025/2026.  
Dokumentet- raportet e dërguara janë:
  - Draft- raportet e detajuara për shqyrtimin tarifar për sezonin 2025/2026;
  - Pasqyrat rregullative me të dhëna të parashikuara për sezonin 2025/2026;
  - Shpalosjen e pasqyrës B.
- Raportin tremujor-TM2 për vitin 2025, për plotësimin e kushteve të Licencës së "Furnizimit publik me energji termike" dhe Licencës së "Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë termike".
- Draft- "Procedurën e leximit të matësve të energjisë termike dhe faturimit të konsumatorëve" e NP "Termokos" Sh.A, në të cilën është integruar Metodologjia e matjes dhe faturimit të energjisë termike.
- Përgjigjet e "Termokosit" dhe dokumentet plotësuese, bazuar në komentet e ZRRE-së lidhur me "Aplikimin për shqyrtimin tarifar të energjisë termike për sezonin 2025/26".
  - Përgjigjet në komentet e ZRRE në Aplikacionin për tarifa të NP "Termokos" Sh. A. për sezonin 2025/2026;
  - Raportet e detajuara për shqyrtimin tarifar për sezonin 2025/2026 - e përmirësuar;
  - Pasqyrat rregullative me të dhëna të planifikuara për sezonin 2025/2026- e përmirësuar;
  - Shpalosjen e pasqyrës B- e përmirësuar;
  - Janë dërguar këto dokumente plotësuese lidhur me sqarimet e kërkuara nga ZRRE:
    - a) "Kontrata për punët e paplanifikuara për ndërtimin e objektit administrativ;
    - b) "Kontrata për punët e paparashikuara për ndërtimin e objektit administrativ;
    - c) "Dokumenti- Adendum.02\_- për projektin Prishtina Heat Save"- nga ENERCO;
    - d) "Tabela e shpenzimeve të planifikuara për projektin Solar 4 Kosova II".
  - Sqarimet plotësuese për Draft- "Procedura e leximit të matësve të energjisë termike dhe faturimit të konsumatorëve" e NP "Termokos" Sh.A, në të cilën është integruar Metodologjia e matjes dhe faturimit të energjisë termike, bazuar në komentet e dhëna nga ZRRE.

### Nga ZRRE kemi pranuar:

- Kërkesën për dërgimin e të gjitha dokumenteve, të cilat kanë pësuar ndryshime, që nga viti 2021, viti kur kemi aplikuar për vazhdim të licencës së Prodhimit, në pajtim me Aplikacionin për Licencim;
- Komentet e ZRRE-së lidhur me Draft raportet e dërguara në kuadër të aplikimit tarifar për sezonin 2025/2026.

### Në Ministrinë e Ekonomisë- ME janë dërguar:

- Raporti mbi progresin e projekteve zhvillimore të NP "Termokos" Sh.A, gjatë periudhës gjashtëmujore (janar- qershor) 2025, të kërkuar nga Departamenti i Energjisë/ Ministria e Ekonomisë;
- Raportin e progresit për projektet zhvillimore të NP "Termokos" Sh.A, gjatë periudhës (janar- qershor) 2025, në kuadër të hartimit të raportit të progresit të "Zbatimit të Programit të Strategjisë së Energjisë";
- Raporti mbi progresin e projekteve zhvillimore të NP "Termokos" Sh.A, gjatë periudhës (janar- 31 dhjetor) 2024;
- Raportin me plotësimet dhe përmirësimet nga NP "Termokos" Sh.A, lidhur me rishikim të afateve dhe buxhetit për projektet e paraqitura në Draft- raportin e progresit (janar- qershor) 2025 të PZSEK-së për periudhën 2022-2025;
- Raporti me të dhënat për realizimin e projekteve të NP "Termokos" Sh. A, për periudhën TM3 (korrik- shtator) 2025, lidhur me "Raportin e zbatimit të Planit Kombëtar për Zhvillim 2025-2027";
- Raportin mbi Raportimin e Planit të zbatimit të Energjisë 2026- 2028, lidhur me planifikimin e zhvillimit të projekteve të NP "Termokos" Sh.A. në aspektin financiar për periudhën

2026-2028.

Në Agjensionin e Statistikave të Kosovës- ASK është dërguar:

- Raporti me të dhënat e kërkuara për periudhën TM2 -2025.

## Inspektimi, mbrojtja dhe siguria në punë

Në kuadër të mbikëqyrjes/ inspektimit të aktiviteteve të mbrojtjes dhe sigurisë në punë dhe MKZ-së, gjatë periudhës raportuese korrik-shtator 2025, janë realizuar këto aktivitete:

Divizioni i Mbrojtjes dhe Sigurisë në Punë ka mbajtur evidencë të saktë të mjeteve mbrojtëse dhe pajisjeve kundër zjarrit, duke bashkëpunuar me menaxhmentin për zbatimin e masave në punë. Janë kryer kontrole të vazhdueshme për përdorimin e rrobave dhe pajisjeve mbrojtëse nga stafi, është monitoruar ndalimi i pirjes së duhanit në ambientet e mbyllura dhe janë dhënë vërejtjet përkatëse për shkeljet. Divizioni ka bashkëpunuar me mirëmbajtësit e oborrit për rregullimin dhe pastrimin e hapësirave të jashtme në "Termokos". Gjithashtu, është menaxhuar projekti për furnizim me rroba dhe këpucë pune për stafin e ndërmarrjes, si dhe është finalizuar kontrollimi, servisimi dhe mbushja e pajisjeve kundër zjarrit (AKZ) sipas nevojës.

## Divizioni i sigurimit

Në kuadër të Divizionit të sigurimit gjatë periudhës raportuese korrik-shtator 2025, janë realizuar këto aktivitete:

Gjatë muajve korrik, gusht dhe shtator 2025, Divizioni i sigurimit ka realizuar detyrat e rregullta të sigurimit fizik në objektet e NP "Termokos" Sh.A. dhe në Ngrohtoren tek spitali, duke evidentuar hyrje-daljet e personelit dhe automjeteve, si dhe kontrolluar materialet, që hyjnë dhe dalin nga ndërmarrja. Po ashtu, është ofruar asistencë për konsumatorët që kanë kërkuar ndihmë dhe janë përcjellë aktivitetet përmes kamerave të sigurisë, me ndërhyrje/verifikime të nevojshme në raste të dyshimeve për gabime financiare të arkatarëve. Detyrat janë kryer me përgjegjësi dhe në vazhdimësi pa ndërprerje.

## Raporti nga mbikëqyrësit e objektit administrativ gjatë ndërtimit për periudhën korrik-shtator 2025

Ndërtimi i objektit të ri administrativ dhe renovimi i hapësirave përcjellëse të NP "Termokos" Sh.A – Ritender, me numër të kontratës 23-1791-511/C163.

**OBJEKTI:** "Ndërtimi i objektit të ri administrativ dhe renovimi i hapësirave përcjellëse të NP "Termokos" Sh.A – Ritender", me numër të kontratës 23-1791-511/C163.

**Vlera e kontratës:** 2,433,753.60 €.

**Punëkryesi:** OE "LimitProject SH.P.K.; Delta-CAD SH.P.K.; Rinesa SH.P.K.; Ilea GR SH.P.K."

**Menaxherë dhe OM të kontratës nga "Termokosi":**

Zyhrie Pillana, Ibrahim Gërvalla, Adem Govori, Gazmend Selimi.

### **Përmbajtja e projektit:**

Projekti përfshin ndërtimin e objektit administrativ si dhe trajtimin e objekteve përcjellëse dhe hapësirave të jashtme, duke përfshirë infrastrukturën rrugore, instalimet nëntokësore, parkingjet, sheshin, hapësirat gjelbëruese, mbjelljen e drunjve, rrethojën e parcelës, ndriçimin, etj.

Objekti administrativ ka sipërfaqe të përgjithshme prej 1,200 m<sup>2</sup>, me përmasa 36x30 m dhe me etazhitet S+P+3 (suterani, përdhësa dhe tri kate).

Në kuadër të këtij projekti, përveç ndërtimit të vazhdë, janë paraparë edhe të gjitha punimet përfundimtare (suvatimet, molerimet, fasadimet, veshja me pllaka, plafonet, hidroizolimet, termoizolimet, dyert, dritaret, etj.), si dhe instalimet e nevojshme elektrike, ujësjellësi, kanalizimi, makineria, interneti, etj. Për objektin administrativ nuk është i përfshirë inventarizimi.

### **Trajtimi i objekteve përcjellëse:**

Në kuadër të projektit janë paraparë rrënimet dhe pastrimet nga të gjitha objektet apo gjësendet e panevojshme apo të papërdorshme brenda parcelës. Po ashtu, është paraparë edhe trajtimi i kufizimit me fasadë metalike për dy rezervuarët e mbetur, si dhe për një pjesë të objektit ekzistues të stacionit për energji.

### **Trajtimi i hapësirave të jashtme (oborrit):**

Është paraparë ndërtimi i infrastrukturës rrugore nga hyrja ekonomike në drejtim të objektit administrativ, respektivisht depos, si dhe nga hyrja kryesore në drejtim të parkingjeve dhe lidhja me rrugën në hyrjen ekonomike. Gjithashtu, siç është cekur më lart, është paraparë ndërtimi i parkingjeve dhe i sheshit (hapësirës qendrore). Po ashtu, është paraparë trajtimi i të gjithë hapësirës së mbetur të jashtme: mbjellja me bar, mbjellja e drunjëve, shkurreve, etj.

Gjithashtu, me projekt është planifikuar rrethimi i komplet parcelës, kanalizimi atmosferik, ndriçimi, etj.

### **Plani dinamik i punimeve (18 muaj):**

Punimet kanë filluar më 08.08.2023 dhe sipas kontratës është dashur të përfundojnë në muajin shkurt. Mirëpo, për shkak të disa punimeve shtesë, punëve të paparapara dhe pengesave të paparashikuara, plani dinamik është shtyrë për së paku edhe 3 muaj, që do të thotë se kontrata pritet të finalizohet në muajin qershor 2025.

### **Vëllimi i punimeve:**

Punimet e vazhda të objektit administrativ kanë përfunduar. Aktualisht janë duke u realizuar punimet e instalimeve të brendshme përkatëse, suvatimet, ndarjet e brendshme me knauf, dhe shumë shpejt do të fillojë vendosja e xhamit për fasadën e jashtme (profilët tashmë janë montuar më herët).

Po ashtu, janë duke vazhduar punimet në hapësirat e jashtme të objektit (shkallët e jashtme, rampa, cokla për rrethojën e parcelës). Kanë filluar gërmimet e nevojshme për trasenë e rrugës, demolimet dhe pastrimet e ndryshme nga asfalti i dëmtuar paraprak, betonet dhe gjësendet e panevojshme. Gjithashtu, ka filluar nivelizimi dhe pastrimi i hapësirave që do të mbillen me bar dhe me drunj dekorativë.

### **Pagesat e realizuara deri më tani:**

Totali: rreth 1.88 milion euro, përfshirë situacionet për punë të planifikuara, punë shtesë dhe punë të paparapara:

- 16 situacione për punë të planifikuara: 1,627,354 €
- 3 situacione për punë shtesë: 130,160 €
- 2 situacione për punë të paparapara: 125,737 €

### **Sfidat gjatë implementimit të projektit:**

Gjatë zbatimit të projektit janë hasur disa pengesa dhe sfida, të cilave u është dhënë zgjidhje në mënyrë graduale.

Aktualisht, po punohet në fasadimin e objektit – vendosjen e xhamave, si dhe në instalimet e brendshme të objektit (vendosja e pllakave në banjo, laminatit, etj.).

Megenëse moti është përmirësuar, punimet janë duke vazhduar edhe në fazat tjera të projektit, përfshirë zhvillimin e punimeve në oborr dhe hapësirat, që e rrethojnë objektin.

Jemi në fazën finale të punimeve brenda objektit administrativ dhe presim që në afatin sa më të shkurtër kohor të përfundojnë të gjitha punimet.

Për sa i përket ambientit të jashtëm- oborrit jemi në vazhdim e sipër, ku janë duke u kryer punimet, mirëpo pengesë po shkaktojnë objektet dhe gjësendet e ndryshme e për të cilat ende nuk është bërë ndonjë zgjidhje përfundimtare.


# Investimi më i madh në Kosovë në sistemin e ngrohjes qendrore që nga vitet e 70-ta

Në kuader të përmirësimit të sistemit të ngrohjes qendrore, janë investuar mbi **Eur 37.1 mil.** Financimi i projektit të kogjenerimit është bërë nga Bashkimi Evropian Eur 13.8mil, Oeveria Gjermane & KfW Eur 15.0 mil., Oeveria e Luksemburgut Eur 1.5 mil., Oeveria e Suedisë Eur 1.9 mil., Oeveria e Kosovës Eur 1.2 mil dhe Komuna e Prishtinës Eur 3.8mil.

PRODIMI I ENERGJISË  
TERMIKE

# Skema e funksionimit të sistemit të koogjenerimit

Figura 2. Skema e funksionimit të sisitemit të koogjenerimit



## DEPARTAMENTI I PRODHIMIT

### RAPORTI I PUNËVE TË REALIZUARA SIPAS PLANIT AKSIONAL 2025 TË PRODHIMIT/KOOGJENERIMIT

#### Divizioni i makinerisë

Në vijim në mënyrë të përmbledhur i paraqesim aktivitetet e Divizionit të makinerisë gjatë periudhës raportuese korrik-shtator 2025

**Tabela 11. Aktivitetet e Divizionit të makinerisë gjatë periudhës raportuese korrik-shtator 2025**

| Nr. | Përshkrimi                                                                                                                        | Data        | Vërejtje                                                                                                                               |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | Mirëmbajtja e pusetave të kogjenerimit                                                                                            | Korrik 2025 |                                                                                                                                        |
| 2   | Pastrimi i mbetjeve të metala nga oborri përreth ngrohtores                                                                       | 10.07.2025  |                                                                                                                                        |
| 3   | Revizioni i stacionit të ri të mazutit                                                                                            | 10.08.2025  | Është bërë revizioni total i stacionit të mazutit, janë pastruar filtrat                                                               |
| 4   | Kalibrimi i valvolës siguruese të Kaldajës K-4                                                                                    | 15.08.2025  | Janë kalibruar dhe montuar valvolat siguruese të kaldajës 4                                                                            |
| 5   | Kalibrimi i valvolave siguruese 1 dhe 2 te ngrohtorja e spitalit                                                                  | 18/08/2025  | Janë kalibruar, që të dy valvolat siguruese dhe janë montuar                                                                           |
| 6   | Kalibrimi i valvolave siguruese të këmbesëve: 1, 2, 3 dhe 4 dhe valvola siguruese e rrjetit në stacionin e "Bregut të Diellit"    | 19/08/2025  | Edhe valvolat siguruese në stacionin e "Bregut të Diellit" janë kalibruar dhe montuar                                                  |
| 7   | Kalibrimi i valvolave siguruese të këmbesëve të nxehtësisë: 1, 2, dhe 3 në HRS                                                    | 20/08/2025  | Edhe në stacionin e HRS janë kalibruar dhe montuar valvolat siguruese                                                                  |
| 8   | Kalibrimi i valvolave siguruese të kondenzatorëve të nxehtësisë: 1 dhe 2 në HES-it                                                | 27/08/2025  | Kurse kalibrimi i valvolave siguruese të këmbesëve në stacionin e HES-it është në proces                                               |
| 9   | Pastrimi i filterit në hyrje në stacionin HRS                                                                                     | 29/08/2025  | Është pastruar filteri në hyrje të stacionit të HRS                                                                                    |
| 10  | Ndërimi i valvolave DN200 në pjesën primare dhe sekondare në këmbes të nxehtësisë                                                 | Gusht 2025  | Nuk është kryer kjo pikë mungojnë valvolat DN200mm                                                                                     |
| 11  | Pastrimi i këmbesëve të nxehtësisë sipas nevojës                                                                                  | Gusht 2025  | Kjo pikë e paraparë në muajin gusht është shtyer për muajin shtator                                                                    |
| 12  | Kontrollimi i valvolave hyrje- dalje të këmbesëve, dhe të tjera në stacionin e "Bregut të Diellit"                                | Shtator     | Janë kontrolluar të gjitha valvolat në hyrje- dalje të këmbesëve në nëstacionin e "Bregut të Diellit"                                  |
| 13  | Revizioni i valvolave në pjesën primare dhe sekondare, hyrje-dalje të objektit në stacion të "Bregut të Diellit"                  | Shtator     | Është bërë revizioni i valvolave në pjesën primare dhe sekondare, hyrje-dalje të objektit                                              |
| 14  | Revizioni i pompave qarkulluese Etanorm, pompave qarkulluese (72P1, 71P2, 72P3), sipas nevojës në stacionin e "Bregut të Diellit" | Shtator     | Edhe pompave qarkulluese në stacionin e "Bregut të diellit" i është bërë kontroll. Gjendja e tyre është e mirë dhe të gatshme për punë |
| 15  | Revizioni i enëve ekspanduese dhe valvolave përcjellëse në stacionin e "Bregut të Diellit"                                        | Shtator     | Janë kontrolluar enët ekspanduese dhe valvolat në stacionin e "Bregut të Diellit"                                                      |
| 16  | Kontrollimi i pompave qarkulluese në stacionin e ri të mazutit brenda objektit NQ në stacionin e ri të mazutit                    | Shtator     | Pompat te stacioni i ri i mazutit brenda objektit të NQ janë kontrolluar.                                                              |
| 17  | Kontrollimi i manometrave dhe termometrave në stacionin e ri të mazutit sipas nevojës ndërimi i tyre në NQ                        | Shtator     | Manometrat dhe termometrat në stacionin e ri të mazutit                                                                                |
| 18  | Pastrimi i gypave të transmierave në stacionin HRS.                                                                               | Shtator     | Janë pastruar të gjithë gypat e transmierëve në stacionin e HRS-së                                                                     |
| 19  | Pastrimi i gypave të transmierave në stacionin HES Obiliq                                                                         | Shtator     | Edhe në stacionin HES-it në Obiliq janë pastruar të gjithë gypat e transmierëve                                                        |
| 20  | Mirëmbajtja e pajisjeve stabilimenteve në stacionin e HES-it Obiliq                                                               | Shtator     | Të gjitha paisjet në stacionin e HES-it ju është bërë mirëmbajtja                                                                      |





|    |                                                                                     |         |                                                                                                                                           |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 21 | Kontrolli i valvolave dhe pajisjeve të tjera në stacionin e HES-it Obiliq           | Shtator | Po ashtu edhe valvolat janë kontrolluar në HES.                                                                                           |
| 22 | Montimi i pjesëve të pompave të kondenzatit në stacionin HES-it Obiliq              | Shtator | Është bërë revizion i tri pompave të kondenzatit dhe është konstatuar se janë në gjendje të rregullt dhe nuk ka nevojë të montohen pjesët |
| 23 | Ndërrimi i valvolave DN200 në pjesën primare dhe sekondare në këmbyes të nxehtësisë | Shtator | Nuk është e kryer mungojnë valvolat                                                                                                       |
| 24 | Pastrimi i këmbyesit 1 në stacionin e "Bregut të Diellit"                           | Shtator | Janë pastruar fletëzat e këmbyesit 1 dhe është montuar pa probleme                                                                        |

#### Përmbledhje:

Në muajin korrik 2025 është bërë pastrimi nga mbetjet e metalta rreth ngrohtores. Me datë 28.07.2025, kemi krijuar kushtet teknike dhe kemi lëshuar në punë pumpen e kogjenerimit 122P001, në intervalin kohor: 11:00-14:00. Ka vazhduar puna nga OE "Zelonis Kosova" në projektin "Inspektim dhe testim të kondenzatorëve të nxehtësisë në stacionin HES".

Me kërkesë të distribuimit gjatë korrikut është mbajtur presioni në rrjetë në 3.9-4.0bar. Për mbajtjen e presionit konstant në rrjetë është dashur të fusim ujë të fortë nga ujësjellësi, që kanë krijuar shpenzime të ujit në mesatare në ditë 161 m³ në 24h, dhe është dashur të punojmë me një pompë të mbajtjes së presionit në rrjetë të distribuimit. Uji i humbur në rrjetë të kogjenerimit është shkaktuar nga drenazhimi i bërë në stacionet HES dhe HRS.

Është bërë largimi i ujit të grumbulluar me pompë mobile nga puseta MH-4, disa herë.

Me datë 25.08.2025, ka filluar implementimi i projektit "Izolimi i gypave tek Llaguna", puna e cila është duke u realizuar nga OE "AllZone".

Me kërkesë të distribuimit gjatë gushtit është mbajtur presioni në rrjetë në 5 bar. Për mbajtjen e presionit konstant në rrjetë është dashur të fusim ujë të fortë nga ujësjellësi, që kanë krijuar shpenzime të ujit në mesatare në ditë 190 m³ në 24h, dhe është dashur të punojmë me një pompë të mbajtjes së presionit në rrjetë të distribuimit. Uji i humbur në rrjetë të kogjenerimit është shkaktuar nga drenazhimi i bërë në stacionet HES dhe HRS.

Me datë 04.09.2025, kemi lëshuar në punë pumpën e kogjenerimit 122P001 me ngarkesë minimale 42%, dhe ka punuar dy orë, për arsye të ftohjes së kondenzatorit të nxehtësisë për të ulur temperaturën në kondenzator për ta mundur demontim e valvolës siguruese në këmbyesin 1.

Në muajin shtator 2025, gypat e avullit nga TC B kanë qenë të kondicionuar me avull dhe kondenzatori 1, kurse gypi i avullit nga blloku B2 dhe kondenzatori 2 kanë qenë në mungesë të avullit për shkak të remontit të Bllokut B2. Në javën e fundit të muajit shtator 2025 kemi hapur këmbyesin e nxehtësisë 1 në stacionin kryesor "Bregu i Diellit" dhe është bërë pastrimi kimik i fletëzave. Gjatë pastrimit të fletëzave është vërejtur se pllakëzat e këmbyesit janë të konsumuara (të dëmtuara), dhe gjendja e tyre teknike nuk siguron cilësi të ngrohjes në stacionin "Bregu i Diellit". Këmbyesit që nga viti 2004, kur janë instaluar nuk është bërë ndërrimi i fletëzave për shkak të mungesës së tyre. Ne kemi planifikuar ndërrimin e tyre vazhdimisht në buxhetet vjetore të kaluara, por ndërrimi ka dështuar pas shpalljes së tenderit publik. Pas përfundimit të sezonës së kaluar kemi inicuar procedurë të prokurimit për ndërrimin e dy këmbyesëve të nxehtësisë 1 dhe 3 në stacionin BD, por ka dështuar tenderi. Andaj, kemi kërkuar të riprocedohet me procedurë të prokurimit për furnizim të dy këmbyesëve të nxehtësisë në BD, që të sigurojmë një cilësi të ngrohjes për pjesën e "Bregut të Diellit".

Është bërë inspektim i vazhdueshëm i pusetave të kogjenerimit në mënyrë të vazhduar (dhe sipas nevojës është larguar uji i grumbulluar në pusetën MH-4).

Si përfundim për realizimin e planit aksional 2025, jemi përgatitur teknikisht për sezonën e ardhshme 2025/2026, me përjashtim të problemeve me këmbyesit e vjetëruar (dhe të dëmtuar) në BD. Në fillim të muajit tetor 2025, do të bëhen testimet e nevojshme të stabilimenteve termoenergjetike para startimit të sezonit ngrohës 2025/2026.





## RAPORTI I PUNËVE TË REALIZUARA SIPAS PLANIT AKSIONAL 2025 TË PRODHIMIT/KOOGJENERIMIT

### Divizioni i Elektrikës

**Tabela 12.** Aktivitetet e Divizionit të elektrikës gjatë periudhës raportuese korrik-shtator 2025

| Nr.                    | Përshkrimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Data       | Vërejtje                                                                                                                                                                                                           |
|------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1                      | Kontrollimi dhe intervenimi në ndriçimin brenda dhe jashtë ndërtesës së prodhimit dhe në rastet e nevojshme instalimi i ndriçimit automatik me sensor                                                                                                                                                                                                                                    | 18.07.2025 | Kompletimi i kalimit të ndriçimit nga gypat neon në panela led, në korridorin e përdhësës, katin e parë (tek zyret e inxhinierëve), dhoma e tensionit 10kV/ - 0.4kV dhe në dhomën e gjeneratorit                   |
| 2                      | Nxemsat elektrik në gypat e mazutit të K1 & K2<br>Kontrollimi i nxemësave në gypa;<br>Izolimi i gypave, aty ku është e nevojshme;<br>Kaldaja Nr. 3 (kaldaja për nevoja të brendshme)<br>Kontrollimi i flakëruesit;                                                                                                                                                                       | 08.07.2025 | Janë kontrolluar nxemësat elektrik në gypat e mazutit                                                                                                                                                              |
| 3                      | Kontrollimi i pompës qarkulluese dhe sinjaleve komanduese;<br>Kontrollimi i nxemësave në rezervuarin ditor.<br>Kompletimi i ndriçimit në kthinën e kaldajës;<br>Pastrimi i të gjitha PC-ve në dhomën e kontrollit dhe punët tjera në pultin komandues:<br>Serverët në pultin komandues;<br>PC-ja për stacionin "Bregu i Diellit" e vendosur në pultin komandues;<br>PC-ja për ES Client. | 09.07.2025 | Është kontrolluar kaldaja nr.3, përfshirë flakëruesin, sinjalet komanduese dhe pompën qarkulluese                                                                                                                  |
| 4                      | Pastrimi i pajisjeve elektronike në pultin komandues;<br>Rregullimi dhe përforsimi i përcësëve në kanale;<br>Ndërrimi i butonëve të dëmtuar;<br>Kompletimi me llamba për sinjalizim;                                                                                                                                                                                                     | 06.08.2025 | Është filluar me punë në pastrimin e PC-ve dhe kontrollimin e pajisjeve tjera përcjellëse në dhomën e kontrollit HRS                                                                                               |
| 5                      | Zëvendësimi i panelit ekzistues elektrik në dhomën tek gjeneratori me panel të ri elektrik dhe njëkohësisht kompletimi i panelit me komponentet e nevojshme;                                                                                                                                                                                                                             | 05.08.2025 | Kemi përfunduar punën me panelin elektrik në dhomën tek gjeneratori, me ç'rast paneli i vjetër dhe me gjëra të panevojshme është zëvendësuar me panelin e punuar nga ne dhe është instaluar në pozicionin përkatës |
| 6                      | Pajisjet për matjen e temperaturës:<br>Testimi i termoelementeve, pastrimi i tyre nga mbeturinat dhe ndërrimi i tyre në rastet e nevojshme.<br>Kontrollimi i kablove të sinjaleve komanduese, nga pajisjet deri në pultin komandues;                                                                                                                                                     | 26.09.2025 | Është bërë kontrollimi dhe testimi i pajisjeve për matjen e temperaturës në HRS                                                                                                                                    |
| 7                      | Pajisjet për matjen e nivelit:<br>Testimi i pajisjeve të nivelit dhe pastrimi i tyre nga mbeturinat në rastet e nevojshme;<br>Kontrollimi i kablove të sinjaleve komanduese, nga pajisjet deri në pultin komandues;                                                                                                                                                                      | 16.09.2025 | Pastrimi dhe testimi i nivel matësve në rezervuarët e kogjenerimit dhe testimi i tyre                                                                                                                              |
| <b>Nënstacioni HES</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |            |                                                                                                                                                                                                                    |
| 8                      | Elektromotorët dhe inverterët Vfd të pompave qarkulluese të kondenzatit.<br>Pastrimi i elektromotorëve dhe inverterëve Vfd;<br>Shtërgimi i kablove në elektromotorë dhe inverterët Vfd;<br>Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve komanduese;<br>Transmiterët e shtypjes;<br>Kontrollimi i transmetereve dhe pastrimi i gypave impulsiv i të gjithë                  | 25.09.2025 | Është bërë pastrimi i inverterëve Vfd dhe elektromotorëve në stacionin HES, njëkohësisht edhe kontrollimi i sinjaleve komanduese. Përveç saj, është pastruar në tërësi stacioni nga brenda                         |
|                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | 11.09.2025 | Kemi bërë pastrimin e gypave impulsiv të transmetereve të shtypjes së bashku me divizionin e makinerisë dhe kemi bërë kontrollimin e                                                                               |



|                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|-----------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                               | transmiterëve;<br>Kontrollimi i kabllove të sinjaleve komanduese, nga pajisjet deri në panelin kryesor të sinjaleve;                                                                                                                                                                                                                     |            | sinjaleve komanduese në stacionin HES                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| 9                                             | Pajisjet për matjen e temperaturës:<br>Testimi i termoelementeve, pastrimi i tyre nga mbeturinat dhe ndërrimi i tyre në rastet e nevojshme.<br>Kontrollimi i kabllove të sinjaleve komanduese, nga pajisjet deri në panelin kryesor të sinjaleve                                                                                         | 11.09.2025 | Është bërë kontrollimi dhe testimi i termoelementeve dhe sinjaleve komanduese                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <b>Nënstacioni kryesor "Bregu i Diellit "</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 10                                            | Kontrollimi i kontrollit të programueshëm PLC, releve, shndëruesve dhe pjesëve tjera përbërëse të panelit komandues                                                                                                                                                                                                                      | 15.07.2025 | Është bërë kontrollimi i kontrollit PLC, releve dhe pjesëve tjera të panelit komandues në stacionin "Bregu i Diellit"                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| 11                                            | Kontrollimi i ndriçimit të jashtëm dhe modifikimi i ndriçimit të brendshëm në stacionin "Bregu i Diellit"                                                                                                                                                                                                                                | 22.07.2025 | Është përfunduar puna me gjithë instalimin e ndriçimit të brendshëm, i bazuar në reflektor, përfshirë gjithë pjesët përbërëse (kablo, lidhëse, ndërprerësa etj). Njëkohësisht është filluar me punë edhe në ndriçimin e jashtëm                                                                                                                                                                                                                                    |
| 12                                            | Kontrollimi i pajisjeve në sistemin për mbajtje të shtypjes në stacionin "Bregu i Diellit"                                                                                                                                                                                                                                               | 15.08.2025 | Kemi kontrolluar sistemin për mbajtje të presionit në stacionin "Bregu i Diellit"                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| 13                                            | Kontrollimi i ndriçimit të jashtëm dhe modifikimi i ndriçimit të brendshëm në stacionin "Bregu i Diellit"                                                                                                                                                                                                                                | 08.08.2025 | Kemi përfunduar punën me ndriçimin e brendshëm dhe të jashtëm në stacionin "Bregu i Diellit", për mungesë furnizimi dhe njëkohësisht kemi zëvendësuar poçat elektrike me reflektor.<br>Përveç saj, është instaluar senzori dhe tani ndriçimi i jashtëm në stacionin "Bregu i Diellit" bëhet në mënyrë automatiqe                                                                                                                                                   |
| 14                                            | Elektromotorët dhe inverterët Vfd të pompave qarkulluese.<br>Pastrimi i elektromotorëve dhe inverterëve Vfd;<br>Shtrëngimi i kabllove në elektromotor dhe inverterët Vfd;<br>Shtrëngimi i përcuesve elektrik në ndërprerësit termik për tri pompat qarkulluese;<br>Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve komanduese | 17.09.2025 | Është përfunduar puna me pastrimin e elektromotorëve dhe inverterëve Vfd, njëkohësisht, kontrollimi i kabllove dhe testimi i sinjaleve komanduese.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>Punët jashtë planit</b>                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 15                                            | Pastrimi i oborit të ndërmarjes nga gjërat e forta                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 10.07.2025 | Së bashku me gjitha divizionet e DPK është punuar në pastrimin e oborit nga gjërat e forta, me qëllim të lirim të hapësirave për shkak të asfaltimit, që do të bëhej nga OE Limit.                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 16                                            | Faturat e energjisë elektrike nga furnizuesi KesCO                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 17.07.2025 | Janë kontrolluar faturat e energjisë elektrike nga KesCO, për periudhën e pakalkuluar nga fatura paraprake, respektivisht për ditët e fundit të muajit maj. Njëkohësisht, kam vërejtur një gabim nga ana e tyre, për të cilën janë informuar dhe lista e faturave është nënshkruar pa faturën në fjalë.                                                                                                                                                            |
| 17                                            | Intervenimi nga OE Limit, në kabllin e dëmtuar nga ana e tyre                                                                                                                                                                                                                                                                            | 13.08.2025 | Pas shumë përpjekjeve, edhe pse rekomandimi im ishte të bëhet vazhdimi i kabllos të re nga puseta në pusetë, sido që të jetë OE ka vendos për riparimin e kabllos 10kV, e cila është riparuar.<br>Në datën 13.08 kemi komunikuar me Keds-in për vënien në tension të kablilit të riparuar, respektivisht testimin e kablilit dhe pas punës së bërë ka rezultuar se kabli i riparuar 10kV "B" tani është në gjendje funksionale dhe jemi të furnizuar nga kabli "B" |
| 18                                            | Pranimi i faturave të energjisë elektrike nga furnizuesi KEK                                                                                                                                                                                                                                                                             | 15.08.2025 | Kishte shumë vonesë në pranimin e faturës të energjisë elektrike për muajin qershor, me ç'rast në mënyrë elektronike faturën e kemi pranuar në datën 28.07.2025 ndërsa në arkivë është pranuar vetëm në datën 15.08.2025. Për këtë çështje disa herë kam adresuar email tek personat përgjegjës në KEK                                                                                                                                                             |
| 19                                            | Inspektimi i transformatorëve, tokëzimit dhe rufepritësit brenda NP "Termokos"                                                                                                                                                                                                                                                           | 09.08.2025 | Prezent në ndërmarje ishte kompania Risamont, me ç'rast është bërë inspektimi i 4 transformatorëve brenda ndërmarjes sipas kontratës, e cila njëkohësisht ishte kërkesë edhe e inspektoratit (të paraplanifikuar nga ana jonë) dhe është përfunduar puna, ndërsa më herët ishte bërë                                                                                                                                                                               |



|    |                                                                                                                  |            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    |                                                                                                                  |            | inspektim edhe i tokëzimit dhe rrufepritësit. Në fund kemi pranuar edhe raportin final                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| 20 | Pastrimi i rrjetave rreth transformatorëve                                                                       | 11.08.2025 | Kemi bërë pastrimin e rrjetave rreth katër transformatorëve në ndërmarje                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 21 | Problem me mungesë të disa sinjaleve të këmbës 1 në stacionin HES                                                | 26.08.2025 | Kemi identifikuar problemin me njërin nga modulet e PLC-së në stacionin HES dhe kemi rregulluar problemin në fjalë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 22 | Shkyçja e furnizimit me energji elektrike nga konteneri                                                          | 29.08.2025 | Për shkak të largimit të kontenerit nga OE, kemi asistuar në largimin dhe shkyçjen e kablove nga furnizimi elektrik                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| 23 | Inspektimi i njehsorëve të energjisë elektrike në stacione                                                       | Shtator    | Për shkak të dyshimeve, deri më tani kemi inspektuar njehsorët e energjisë elektrike në distribuim me shifrat si vijon: DPR90153301, DPR90179783, DPR90179796, DPR90180133, DPR90095284, DPR90007021, DPR90007019, DPR90007111, DPR90007123, DPR90007051, DPR90007052, DPR90007128, DPR90089840, DPR90153301, dhe kemi vërejtur shpenzim joracional përfshirë edhe keqpërdorim. Pas intervenimit, kemi ndikuar në kursim financiar dhe tani situata është në rregull për njehsorët e lartëpërmendur, ndërsa do të vazhdojmë me punë në rast se vërehen dyshime |
| 24 | Problem me humbje të disa sinjaleve në këmbësin nr. 2 në stacionin HES                                           | Shtator    | Problemi ishte i ngjajshëm me rastin e muajit gusht, respektivisht është djegur moduli sigurues (HES_AS_001-5F6). Pas hapjes së modulit vërehet depërtim i lagështisë nga avulli apo uji, e cila mund të jetë nga avaria me avull e sezonës së kaluar. E kemi rregulluar në një servis në Prishtinë dhe sistemi mbetet në rregull                                                                                                                                                                                                                              |
| 25 | Ndriçimi në HRS                                                                                                  | 02.09.2025 | Kemi intervenuar në ndriçimin e dëmtuar nga depërtimi i ujit në HRS                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| 26 | Kyçja e pompës së kogjenerimit 122P001 dhe rregullimi i treguesit të energjisë termike                           | 04.09.2025 | Në datën 04.09 është kyçur pompa e kogjenerimit 122P001 për shkak të kërkesës nga divizioni i makinerisë dhe gjithçka ishte në rregull. Ndërkohë është rregulluar edhe treguesi i rrjedhjes dhe energjisë termike në HRS                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 27 | Planifikimi buxhetor për vitin 2026                                                                              | 09.09.2025 | Kemi qenë të angazhaur në planifikimin buxhetor për vitin 2026                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 28 | Rregullimi i problemit me displej-in për tensionin dhe rrymën në kthinën e tensionit të ulët 690V                | 10.09.2025 | Është rregulluar problemi me displej-in e tensionit dhe rrymës në kthinën e tensionit të ulët 690V në HRS dhe tani kemi informacionin për tensionin dhe rrymën                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 29 | Gabim nga ana e KEK-ut në faturën DPR90171476 në distribuim, e cila është faturuar 1,227.61€ në vend të rreth 1€ | 12.09.2025 | Sërish kam vërejtur gabim (fatura më të larta), për të cilën çështje ju kemi adresuar me email Kek-ut, duke mos dëmtuar buxhetin e ndërmarjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| 30 | Takim në inspektorat për gjendjen e transformatorëve 10kV brenda ndërmarjes                                      | 16.09.2025 | Në inspektorat (Ministria e Ekonomisë) kemi dërguar raportin e inspektimit të 4 transformatorëve brenda ndërmarjes NP "Termokos" dhe është diskutuar rreth hapave, që janë ndërmarë dhe do të ndërmiren në aspektin elektroenergjetik                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| 31 | Shfaqja në SCADA e alarmit "Emergency stop HRS"                                                                  | 19.09.2025 | Është shfaqur alarmi "Emergency stop HRS", prandaj pas shumë përpjekjeve dhe testeve të bëra, kemi arritur ta gjejmë prejardhjen e problemit "Emergency stop HRS", ndërsa tani sistemi është në rregull                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| 32 | Ndërprerje e energjisë elektrike nga KEDS-i                                                                      | 22.09.2025 | Për shkak të punëve nga ana e KEDS-it, nuk kemi pasur energji elektrike nga ora 11:00 – 14:00 dhe gjatë kësaj kohe në zonat e mundshme kemi qenë të furnizuar nga gjeneratori, ndërsa pas ardhjes së energjisë elektrike kemi vënë tërë sistemin në funksion                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| 33 | Takim                                                                                                            | 24.09.2025 | Kemi pasur një takim në lidhje me zhvillimin e punëve të zgjerimit të kapacitetit, ndërlidhur me tenderin 1 (Brunata & Ergotem)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |



## RAPORTI I PUNËVE TË REALIZUARA SIPAS PLANIT AKSIONAL 2024 TË PRODHIMIT/KOOGJENERIMIT

### Divizioni i PKU-së

Punët dhe aktivitetet kryesore, të cilat janë kryer në teremujorin e tretë 2025, mund t'i përmbledhim, si në vijim:

Gjatë periudhës kohore korrik, gusht dhe shtator 2025 (TM3-2025) Divizioni i PKU-së në kuadër të realizimit të aktiviteteve dhe përgjegjësi të veta ka vazhduar realizimin e Planit Aksional 2025 dhe vazhdimisht kemi qenë në bashkëpunim me Divizionet tjera të Departamentit të Prodhimit-Koogjenerimit, me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë.

- Është realizuar pastrimi kimik këmbysesëve të nxehtësisë sipas kërkesave të termonënstacioneve të distribuimit e po ashtu prej 25 deri më 30 shtator është realizuar pastrimi kimik i fletëzave të këmbysesëve të nxehtësisë në termostacionin "Bregu i Diellit".
- Plani Aksional 2025 është realizuar në tërësi siç është planifikuar. Fillimi i sezonës ngrohëse 2025 na gjen prap me sistemin e enëve dozuese për kondicionim të ujit, ende jo aktive si dhe jemi në prag të fillimit të servisimit/riparimit të zbutësve për sistem të koogjenerimit.

### Realizimi i Planit aksional 2025 nga Divizioni i PKU-së:

Tabela 13. Realizimi i Planit aksional Divizioni i PKU-së

| Nr. | Përshkrimi                                                                                                                  | Data        | Vërejtje |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|----------|
| 1   | Kontrolli/pastrimi i enës për përgatitjen e tretësirës së kripës NaCl dhe ndërrimi/shtimi eventual i rërës, sitemi i vjetër | Korrik 2025 |          |
| 2   | Kontrollimi i kapakëve dhe kanalit të kanalizimit të sistemit të vjetër të zbutjes                                          | Korrik 2025 |          |
| 3   | Pastrimi kimik i këmbysesëve të nxehtësisë sipas kërkesave nga termonënstacionet                                            | Gusht 2025  |          |

### Pastrimi i këmbysesëve të nxehtësisë

Tabela 14. Pastrimi i këmbysesëve të nxehtësisë nga Divizioni i PKU-së

| Nr.                          | Muaji   | Rajoni                                     | Adresa e nënstacionit | Nr i nënstacioneve |
|------------------------------|---------|--------------------------------------------|-----------------------|--------------------|
| 1                            | Korrik  | Mati 1, Dardania, Ulpiana                  | Të ndryshme           | 9                  |
| 2                            | Gusht   | Mati 1, Dardania, Ulpiana, Bregu i Diellit | Të ndryshme           | 48                 |
| 3                            | Shtator | Bregu i Diellit, Mati 1                    | Te ndryshme           | 24                 |
| Total pastrimi i këmbysesëve |         |                                            |                       | 81                 |






Në TM3/2025 janë instaluar 260 metër gyp me paraizolim dhe 46 metër gyp çeliku.

Instalimi i gypave metër gjatësi në korrik-shtator 2025:

306m'

Figura 3. Instalimi i gypave të paraizoluar dhe të çeliktë



## DEPARTAMENTI I DISTRIBUIMIT

### Aktivitetet e Departamentit të Distribuit

Gjatë periudhës korrik-shtator, Departamenti i Distribuit ka pasur këto aktivitete:

Intervenimet në sistemin primar të ngrohjes;

- Instalimi i gypave,
- Instalimi i kthesave,
- Instalimi i valvolave,
- Instalimi i filtrave
- Instalimi i pompave,
- Instalimi i këmbyesëve
- Pastrimi i këmbyesëve

Intervenimet në sistemin sekondar të ngrohjes;

Instalimi i matësve të energjisë

Kyçjet e reja;

Puna me palë të treta;

Raportimi mbi humbjet e ujit dhe energjisë termike;

Aktivitete tjera.

### Instalimi i gypave

Gjatë periudhës raportuese janë instaluar gjithsej 306 metër gyp me paraizolim dhe çeliku.

Tabela 16. Instalimi i gypave korrik-shtator 2025

| Nr. | Dim.i gypit | Realiz. | Vërejtje                               |
|-----|-------------|---------|----------------------------------------|
| 1   | DN 40       | 36      | Gyp çeliku                             |
| 2   | DN 50       | 80      | 74 m gyp me paraizolim, 6 m gyp çeliku |
| 3   | DN80        | 112     | 108m gyp me paraizolim, 4 m gyp çeliku |
| 4   | DN100       | 48      | Gyp me paraizolim                      |
| 5   | DN250       | 30      | Gyp me paraizolim                      |
|     | TOTAL       | 306     |                                        |

### Instalimi i kthesave

Në peridhën raportuese korrik-shtator 2025 janë instaluar gjithsej 36 kthesa çeliku dhe 8 kthesa me paraizolim.

Tabela 17. Instalimi i kthesave

| Nr. | Dim.i gypit | Realizimi | Vërejtje                                |
|-----|-------------|-----------|-----------------------------------------|
| 1   | DN40        | 16        | Kthesa çeliku                           |
| 2   | DN50        | 5         | 2 kthesa me paraizolim, 3 kthesa çeliku |
| 3   | DN80        | 6         | 2 kthesa me paraizolim, 4 kthesa çeliku |
| 4   | DN100       | 10        | 2 kthesa me paraizolim, 8 kthesa çeliku |
| 5   | DN150       | 4         | Kthesa çeliku                           |
| 6   | DN250       | 3         | 2 kthesa me paraizolim, 1 kthesë çeliku |
|     | TOTAL       | 44        |                                         |

### Instalimi i filtrave

Gjatë periudhës korrik-shtator 2025, s'ka pasur instalime të filtrave.

Tabela 18. Instalimi i filtrave

| Nr. | Dim.i gypit | Realizimi | Vërejtje |
|-----|-------------|-----------|----------|
| 1   |             |           |          |
|     | TOTAL       | -         | Copë     |

### Instalimi i pompave

Gjatë periudhës korrik-shtator 2025, nuk ka instalim të pompave.

Tabela 19. Instalimi i pompave

| Nr. | Dim. pomp | Realizimi | Vërejtje |
|-----|-----------|-----------|----------|
| 1   |           |           |          |
|     | TOTAL     | -         | Copë     |

Tabela 15. Pasqyra përmbledhëse e aktiviteteve të Departamentit të Distribuit gjatë TM3/2025

| nr | Aktiviteti                                     | totali | Njësia      |
|----|------------------------------------------------|--------|-------------|
| 1  | Intervenimet në rrjetin primar të ngrohjes     |        | intervenime |
| 2  | Intervenimet në rrjetin sekondar të ngrohjes   |        | intervenime |
| 3  | Instalimi i gypave të paraizoluar & të çelikut | 306    | m'          |
| 4  | Instalimi i kthesave paraizoluar & të çelikut  | 44     | copë        |
| 5  | Instalimi i këmbyesëve të nxehtësisë           |        | copë        |
| 6  | Instalimi i valvolave të ngrohjes              |        | copë        |
| 7  | Instalimi i pompave qarkulluese                | 0      | copë        |
| 8  | Instalimi i filtrave                           | 0      | copë        |
| 9  | Instalimi i matësve të energjisë               |        | copë        |



## Instalimi i valvolave

Janë instaluar gjithsej 8 valvola të dimensioneve të ndryshme.

Tabela 20. Instalimi i valvolave

| Nr.   | Dim.i valv. | Realizimi | Vërejtje  |
|-------|-------------|-----------|-----------|
| 1     | DN 32       | 2         | Pusetë    |
| 2     | DN 80       | 2         | Pusetë    |
| 3     | DN 100      | 2         | Pusetë    |
| 4     | DN 125      | 2         | Rektorati |
| TOTAL |             | 8         | Copë      |

## Këmbyesit e nxehtësisë

Në TM3/2025 s'ka instalime të këmbyesëve të nxehtësisë

Tabela 21. Instalimi i këmbyesëve të nxehtësisë

| Nr.   | Lloji dhe fuqia | Realizimi | Vërejtje |
|-------|-----------------|-----------|----------|
| 1     |                 |           |          |
| TOTAL |                 | -         |          |

## Pastrimi i këmbyesëve të nxehtësisë

Në periudhën raportuese janë pastruar me kemikate 81 këmbyes të nxehtësisë.

Tabela 22. Pastrimi i këmbyesëve të nxehtësisë

| Nr.   | Adresa      | Realizimi | Vërejtje |
|-------|-------------|-----------|----------|
| 1     | Të ndryshme | 81        |          |
| TOTAL |             | 81        |          |

## Intervenimet në pjesën sekondare

Gjatë periudhës raportuese korrik-shtator 2025 ka pasur vetëm një intervenim me ofertë në pjesën sekondare.

Tabela 23. Intervenimet urgjente në pjesën sekondare

| Nr.      | Rajoni   | Adresa           | Interv. | Përshkrimi i punëve          |
|----------|----------|------------------|---------|------------------------------|
| 1        | Dardania | SU 5/L-15 nr.112 | 1       | Sanimi i rrjedhjes-me ofertë |
| Gjithsej |          |                  | 1       |                              |

## Matësit e nxehtësisë

Gjatë periudhës raportuese, s'ka instalim të matësve të nxehtësisë.

Tabela 24. Matësit e energjisë

| Nr.   | Rajoni | Adresa | Lloji | Realiz. | Data |
|-------|--------|--------|-------|---------|------|
| 1     |        |        |       |         |      |
| TOTAL |        |        |       |         | -    |

## Kycjet ilegale dhe pa proces- të identifikuara

Gjatë periudhës raportuese korrik-shtator 2025 është identifikuar 1 kycje ilegale në sistemin e ngrohjes qendrore.

Tabela 25. Kycjet ilegale dhe pa proces të identifikuara gjatë TM3/ 2025:

| Nr.   | Adresa               | Sip. m2 | vërejtje      |
|-------|----------------------|---------|---------------|
| 1     | SU7/3;Hy.1 lok.nr.77 | 37.10   | Kycje ilegale |
| TOTAL |                      | 37.10   |               |

## Kycjet, rikyçjet dhe shkyçjet me ofertë në rrjetin sekondar

Gjatë periudhës raportuese korrik-shtator 2025 janë kyçur 2 konsumator me sipërfaqe prej 55.75 m<sup>2</sup>. Janë shkyçur 32 konsumatorë, si dhe janë anuluar 8 kërkesa për shkyçje.



Tabela 26. Kycjet, rikyçjet dhe shkyçjet me ofertë në rrjetin e ngrohjes gjatë TM3/ 2025:

| Nr.   | Adresa      | Sip. m2 | Vërejtje                       |
|-------|-------------|---------|--------------------------------|
| 1     | Të ndryshme |         | 32 shkyçje                     |
| 2     | Të ndryshme | 55.75   | Kycje të reja (2 konsumatorë)  |
| 3     | Të ndryshme |         | Anuluar- kërkesa për shkyçje 8 |
| TOTAL |             |         |                                |

## Aktivitetet tjera

- Është bërë kontrollimi, pastrimi dhe rregullimi i ormanëve elektrik në 13 nënstacione;
- Sanimi i rrjedhjes në pjesën primare- degëzimi SHFMU "Xhemajl Mustafa";
- Sanimi i rrjedhjes në pjesën primare- degëzimi – Rr.B 2/5;
- Devijimi i trasesë- pjesa primare- QMFK- "Dardani";
- Instalimi i pompës DN65 së vjetër në pjesën sekondare- Rr.B 4/11
- Degëzimi i "Solidariteteve"- pjesa primare- vendosja e dy valvolave DN125;
- Montimi i enës ekspanduese (500L) në objektin banesor- Rr.B 9/2;
- Pastrimi i filterave në nënstacion- pjesa primare dhe sekondare- Rajonet: "Arbëri", "Dardani", "Oendër", "Ulpianë", "Kodra e Diellit", "Kalabri" dhe "Mati 1".

Figura 4. Paraqitja grafike e instalimit të kthesave, valvolave, pompave, filtra, këmbyesëve dhe matësve të energjisë





Inkasimi në TM3/2025 është 561,906 euro më pak se në TM3/2023.

Rënje e inkasimit krahasuar me tremujorin e vitit paraprak, shprehur në përqindje

-31%

## DEPARTAMENTI I FURNIZIMIT

### Aktivitetet e Departamentit të furnizimit gjatë periudhës korrik-shtator 2025

Në bazë të planit për ngritjen e arkëtimit përfshirë edhe borxhet e është përgatitur plani i aktiviteteve operationale për arkëtim të borxheve të vjetra. Faturimi retroaktiv në periudhën raportuese korrik-shtator 2025 është si në vijim.

Tabela 27. Faturimi në TM3/ 2025, krahasimi me TM3/ 2024:

| Periudha       | TM3/ 2024 | TM3/2023 | Eval. €   | Eval. % |
|----------------|-----------|----------|-----------|---------|
| Total faturimi | 13,841 €  | 39,674 € | -25,833 € | -65%    |


Ndërsa, të hyrat e përgjithshme nga arkëtimi i mjeteve në periudhën korrik-shtator 2025 janë si vijon:

Tabela 28. Inkasimi në TM3/2025, krahasimi me TM3/2024:

| Periudha         | TM3/ 2025   | TM3/ 2024   | Eval. €    | Eval. % |
|------------------|-------------|-------------|------------|---------|
| Amvisëri         | 1,019,566 € | 954,325 €   | 65,240 €   | 7%      |
| Afarist/Institut | 213,282 €   | 840,428 €   | -627,147 € | -75%    |
| Total inkasimi   | 1,232,848 € | 1,794,754 € | -561,906 € | -31%    |

Në vazhdim në mënyrë grafike paraqesim të dhënat e inkasimit për periudhën raportuese korrik-shtator 2025 si dhe krahasimin me korrik- shtator 2024.

Figura 5. Inkasimi në TM3/2025 krahasimi me TM3/2024:



Të hyrat nga arkëtimi i mjeteve për periudhën TM3/ 2025 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë 31% më të vogëla, shprehur në vlerë monetare -561,906€.

### Raporti i ankesave dhe kërkesave gjatë periudhës raportuese korrik-shtator 2025

Në vijim në mënyrë të përmblodhur në formë tabelare paraqesim raportin mbi ankesat dhe kërkesat gjatë TM3/2025.

Tabela 29. Raporti mbi ankesat dhe kërkesat gjatë periudhës raportuese TM3/ 2025.

| Muaji   | Ankesa të pranuara | Përgjigjet në ankesa | Kërkesa të pranuara | Përgjigjet në kërkesa |
|---------|--------------------|----------------------|---------------------|-----------------------|
| Korrik  | 35                 | 132                  | 58                  | 22                    |
| Gusht   | 76                 | 119                  | 124                 | 50                    |
| Shtator | 58                 | 150                  | 210                 | 58                    |
| Total   | 169                | 401                  | 392                 | 130                   |


Sqarim: Janë përfshirë përgjigjet edhe për ankesa dhe kërkesa të bartura nga viti paraprak.

### Kontratat për furnizim me ngrohje

Në periudhën raportuese TM3/ 2025, janë nënshkruar gjithësej 216 kontrata për furnizim me ngrohje me konsumatorë, prej të cilave 193 kontrata nga sektori i amvisërisë dhe 23 nga sektori afarist.

Tabela 30. Kontratat për furnizim të nënshkruara gjatë periudhës raportuese TM3/ 2025.

| Muaji   | Kontrata për furnizim me ngrohje-banesor | Kontrata për furnizim me ngrohje-biznesor | Gjithsejt kontrata të nënshkruara |
|---------|------------------------------------------|-------------------------------------------|-----------------------------------|
| Korrik  | 29                                       | 5                                         | 34                                |
| Gusht   | 41                                       | 2                                         | 43                                |
| Shtator | 123                                      | 16                                        | 139                               |
| Total   | 193                                      | 23                                        | 216                               |





Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit paraprak 2024, në fund të periudhës TM3/ 2025, kemi rritje të numrit të konsumatorëve 702 konsumatorë më shumë dhe kemi rritje të sipërfaqes ngrohëse për 42,769 m<sup>2</sup>

Rritje e sipërfaqes ngrohëse prej

2%

## DEPARTAMENTI I FURNIZIMIT

### Numri aktual i konsumatorëve

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve në fund të periudhës raportuese është 25,283 konsumatorë. Ndërsa, në prill 2024, numri i përgjithshëm i konsumatorëve ishte 24,581. Pra, kemi rritje të numrit të konsumatorëve prej 2.9%.

### Sipërfaqja ngrohëse

Në fund të periudhës raportuese TM3/2025, sipërfaqja ngrohëse është 2,186,444.71m<sup>2</sup>. Në tremujorin e dytë të vitit 2024, sipërfaqja ngrohëse ishte 2,143,676.08m<sup>2</sup>.

Figura 6. Sipërfaqja ngrohëse në TM3/2025, krahasimi me TM3/2024



### Kyçjet e reja

Në periudhën raportuese TM3/ 2024, në sistemin e ngrohjes qendrore "Termokos", nuk ka pasur kyçje të konsumatorëve të rinjë.

Tabela 31. Konsumatorë të rinjë – Kyçje të reja në TM3/ 2025

| Sektori               | Numri i konsumatorëve | Sipërfaqja m <sup>2</sup> |
|-----------------------|-----------------------|---------------------------|
| Amvisëri              | -                     | -                         |
| Afarist/institucional | -                     | -                         |
| Total                 | 0                     | 0 m <sup>2</sup>          |



## DEPARTAMENTI PËR ZHVILLIM DHE INVESTIME KAPITALE

### NJËSIA PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE

Ky raport mbulon progresin e projekteve kryesore të NP "Termokos" SHA për periudhën korrik-shtator 2025, duke përfshirë projektin "Solar4Kosovo II" dhe projektin për dyfishimin e kapaciteteve prodhuese të kogjenerimit.

#### Projektet

NP "Termokos" SHA është duke zhvilluar aktivitete paralelisht në dy projekte:

1. Projekti "Solar4Kosovo II – Solar District Heating", financuar nga KfW, EBRD, WBIF dhe burime vendore;
2. Projekti për dyfishimin e kapaciteteve të kogjenerimit dhe rrjetit të transmetimit nga 140 MWth në 280 MWth, financuar nga EIB, BE dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në këtë periudhë janë shënuar përparime të rëndësishme në fazën e projektimit, planifikimit dhe koordinimit me institucionet financiare ndërkombëtare dhe autoritetet vendore. Po ashtu, janë adresuar një sërë sfidash të ndërlidhura me procedurat e shpronësimit, lejet mjedisore dhe koordinimin ndër-institucional.

#### Projekti "Solar4Kosovo II"

Komponentët e projektit:

- Impianti diellor për ujë të ngrohtë (financuar nga KfW/WBIF);
- Tubacionet e lidhjes (Koridori A dhe Koridori B – financuar nga BERZH);
- Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes në lagjet e reja të Prishtinës.

Objektivat e projektit:

- Dekarbonizimi i sistemit të ngrohjes në Prishtinë;
- Ofrimi i ngrohjes nga burime të ripërtëritshme për lagjet urbane;
- Kursim vjetor i CO<sub>2</sub>: rreth 47.000 ton/vit;
- Prodhim vjetor i energjisë nga BRE: 43 GWh/vit.

Statusi i projektit:

- Koncept dizajni i përfunduar për PTES dhe impiantin diellor;
- Është finalizuar raporti mbi sigurinë e digës dhe dizajni teknik i ndërtesës energjetike;
- U dakordua kapaciteti i pompës termike me absorpcion 20 MW;
- Ka përfunduar strategjia e komunikimit dhe dukshmërisë (C&V)- u lansua faqja zyrtare [www.solar4kosovo2.org](http://www.solar4kosovo2.org) dhe u shpërnda newsletter-i i parë;
- Dokumentet ESIA, ESMP, SEP dhe LALRP janë përditësuar dhe dërguar për No Objection tek donatorët;

- Master plani për zgjerim është aprovuar dhe prezantuar publikisht para qytetarëve;
- Elaboratet e shpronësimit për koridorin A kanë përfunduar dhe janë dorëzuar në MMPHI. Koridori B mbetet çështje për t'u zgjidhur me Komunën e Obiliqit;
- Janë organizuar takime koordinuese të përbashkëta me "Termokos", KfW dhe BERZH dhe konsulentin iC/CES.

Aktivitetet tjera gjatë TM3/2025:

Gjatë periudhës korrik- shtator 2025 janë zhvilluar një sërë aktiviteteve teknike, administrative dhe koordinuese që përfshijnë:

- Pjesëmarrja në takimet dyjavore koordinuese me konsulentin Implementues (iC/CES) dhe NJZP për shqyrtimin e progresit teknik dhe harmonizimin e dokumenteve projektuale;
- Mbajtja e takimit të progresit me përfaqësues të KfW dhe BERZH, ku u diskutuan rezultatet e fazës së parakualifikimit dhe procesi i përgatitjes së tenderit për Lot 1;
- Takime ndër-institucionale me Komunën e Prishtinës, Drejtorinë e Kadastrit për procesin e shpronësimit të tokës për stacionin e pompës përforcuese dhe rishikimin e parcelave alternative;
- Takime me BERZH, "Termokos", CES dhe Enova për rikategorizimin e projektit dhe përshtatjen e dokumenteve të ndikimit mjedisor dhe social;
- Koordinim me konsulentin FOPIP/ESAP (Aspiro dhe Enova) për përgatitjen e raportit nismëtar dhe zhvillimin e intervistave me departamentet e "Termokos".
- Finalizimi dhe publikimi i dokumentit SEP ("Stakeholder Engagement Plan") në faqen zyrtare të "Termokos", si dhe përditësimi i dokumenteve LALRP.
- Nënshkrimi i kontratës për Panelin e Ekspertëve të Pavarur për Sigurinë e Digave (PoE) dhe mbajtja e takimit të parë në gusht 2025; përgatitja e raportit të parë të gjetjeve në shtator;
- Zhvillimi i planifikimit të SCADA-s dhe definimi i kërkesave teknike për integrimin e sistemeve të kontrollit;
- Komunikimi dhe koordinimi i vazhdueshëm me IFI-të, konsulentët dhe autoritetet qeveritare për proceset e tenderimit dhe aprovimeve teknike;
- Përditësimi i master planit të zgjerimit dhe përcaktimi i prioritetëve për zonat "Lakrishte", "Kalabria", "Tophane", "Mahalla e Muhaxherëve" dhe "Qyteti i vjetër";
- Përgatitja e udhëzuesit të brendshëm për komunikim dhe dukshmëri (C&V Manual) dhe trajnimi i stafit të "Termokos" për zbatimin e tij.
- Dorëzimi i elaboratit të shpronësimit për Koridorin A në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe nisja e procedurave për Koridorin B;
- Ndjekja e procedurave të para-kualifikimit për Lot 1, përgatitja e komenteve të PIU dhe koordinimi për finalizimin e dosjes së tenderit për rishpallje në tetor.

Sfidat

- Zvarritje në procesin e shpronësimit për Koridorin B dhe lokacionin e varrezave;
- Mungesë e konfirmimeve për lejet mjedisore dhe kycjes në sistemin e ujësjellësit;

- Vonesë në procedurën e parakualifikimit (PQ) për Lot 1 (vetëm 1 aplikant i kualifikuar- pritet rishpallja në tetor);
- Nevoja për mirëkoordinim ndërmjet institucioneve lokale dhe donatorëve për përshpejtimin e vendimmarrjes administrative.

#### Raportimi Financiar

| Përshkrimi                                               | Vlera (EUR) |
|----------------------------------------------------------|-------------|
| Lot 1 – Impianti solar me PTES, AHP dhe ndërtesë teknike | 55,723,675  |
| Lot 2 – Komponentët e rrjetit dhe integrimi              | 16,857,595  |
| Shpronësim, projektim dhe mbikëqyrje                     | 5,189,322   |
| Totali CAPEX                                             | 77,770,592  |
| Kontigjenca (12%)                                        | 9,332,471   |
| Totali i përgjithshëm i investimit                       | 87,103,063  |

#### Burimet e financimit:

- WBIF Grant: 21,500,000 €
- Kredi KfW: 31,600,000 €
- Kredi EBRD: 18,900,000 €
- Kontributi vetanak: 15,103,063 €

#### Projekti për dyfishim të kapaciteteve

Projekti parashikon dyfishimin e kapacitetit të ngrohjes nga 140 MWth në 280 MWth, përfshirë ndërtimin e linjës së tretë të transmetimit dhe nënstacioneve të reja HES2/HRS2. Financimi është planifikuar nga EIB (kredi), IPA Grant dhe Qeveria e Kosovës.

Shënim: Nga kapaciteti gjenerues prej 140MWTH, i cili do të realizohet me projektin për dyfishimin e kapaciteteve prodhuese të energjisë termike, 40 MWTH energji termike do të ndahen për komunën e Obiliqit, ndërsa 100 MWTH energji termike do të mbeten për NP "Termokos" Sh.A.

#### Objektivat dhe përfitimet

- Rritja e efikasitetit të energjisë dhe sigurisë në furnizim;
- Zëvendësimi i ngrohjes individuale me ngrohje qendrore;
- Ulje neto e emetimeve të CO<sub>2</sub> me rreth 97,447 ton/vit;
- Kontribut në dekarbonizimin e sistemit të ngrohjes deri në vitin 2050.

#### Statusi aktual

- Dokumentet bazë të përfunduara: Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit, Analiza Ekonomiko-Financiare, Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor, Plani i Implementimit, Strategjia e Prokurimit dhe Master Plani i Zgjerimit, Strategjia e dekarbonizimit, Specifikimi teknik i projektit për HES, gypin e transmissioinit dhe HRS.

- Në proces: finalizimi i Elaboratit të Shpronësimit për trasen nga KEK deri te "Termokos";
- Dokumenti i tenderit para finalizimit;
- Vonesa në sigurimin e fondeve për shkak të masave të BE ndaj Kosovës.

#### Raportimi financiar (EIB Project)

| Komponenta                                                            | CAPEX (€)  |
|-----------------------------------------------------------------------|------------|
| 1. Prodhim dhe transmetimi (CHP, ura, stacionet HES/HRS, gypat DN800) | 32,410,681 |
| 2. Rrjeti i ngrohjes- zgjerim sipas Master planit                     | 28,016,280 |
| 3. Dizajn, sigurime dhe përkrahje inxhinierike                        | 2,945,000  |
| Totali i projektit                                                    | 63,371,961 |

#### Burimet e financimit

- EIB Kredi: 31,685,981 €;
- IPA Grant: 17,600,000 €;
- Qeveria e Kosovës: 9,000,000 €;
- Kontributi i "Termokos": 5,085,981 €.

#### Sfidat kryesore

- Sigurimi i fondeve nga BE për shkak të situatës politike;
- Finalizimi i procesit të shpronësimit;
- Marrja e lejeve nga autoritetet komunale dhe qendrore.

#### Aktivitetet gjatë TM3/2025

- Koordinimi me EU, EIB dhe donatorë të tjerë për progresin e projekteve;
- Përgatitja dhe dërgimi i informacionit për raportet mujore dhe tremujore;
- Zhvillimi i takimeve me MMPHI për procesin e shpronësimit të parcelave dhe verifikimin e pronësisë;
- Koordinimi me sektorët e tjerë të ndërmarrjes për integrimin e të dhënave teknike dhe financiare;
- Përgatitja e materialeve prezantuese për takimet me IFI-të dhe menaxhmentin;
- Bashkëpunim i ngushtë me kompaninë konsulente në përgatitjen e dokumentit të tenderit për punë dhe konsulencë.

#### Përfundim

- Projekti "Solar4Kosovo II" është në fazën përfundimtare të përgatitjes për tenderim, me pritje për rishpallje të procedurës së parakualifikimit në tetor 2025;
- Projekti EIB – Dyfishimi i kapaciteteve të kogjenerimit është në fazën e përfundimit të dokumentacionit dhe pritjes së financimit të plotë nga BE dhe Qeveria;
- Sfidat mbeten të lidhura kryesisht me proceset e shpronësimit, lejeve mjedisore dhe vonesave burokratike;
- Departamenti për Zhvillim dhe Investime Kapitale rekomandon vazhdimin e bashkëpunimit të ngushtë me IFI-të dhe institucionet qeveritare për të siguruar zbatimin në afat të projekteve strategjike.



## TË ARRITURAT

Në TM3/ 2025, krahasuar me TM3/ 2024 është arritur:

- ➔ Rritje e numrit të konsumatorëve 3%;
- ➔ Rritje e sipërfaqes ngrohëse 2%;
- ➔ Përparim në konsolidimin e departamenteve të reja;
- ➔ Progres në realizimin e projekteve për zgjerim të rrjetit;
- ➔ Ngritja e shkallës së qëndrueshmërisë afariste të ndërmarrjes.

## SFIDAT

Gjatë punës korrik-shtator 2025 sfidat më të mëdha kanë qenë:

- ➔ Ngritja e inkasimit;
- ➔ Arkëtimi i borxheve të vjetra të trashëguara;
- ➔ Ngritja e çmimeve, gjë e cila ka ndikuar në realizimin e projekteve ekzistuese dhe fillimin e projekteve të reja;
- ➔ Implementimi i rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit;
- ➔ Procedurat e brendshme të departamenteve.

## OBJEKTIVAT

Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve të ngrohjes së qëndrueshme dhe kualitative për konsumatorët ekzistues dhe ata, që do kyçen;

- ➔ Realizimi i projekteve tjera në kuadër të Projektit të Koogjenerimit;
- ➔ Vazhdimi i reformimit të shërbimeve të administratës;
- ➔ Ngritja e nivelit të kontrollit të brendshëm;
- ➔ Vazhdimi i rehabilitimit dhe modernizimit të rrjetit të ngrohjes;
- ➔ Vazhdimi i zgjerimit të rrjetit konform Masterplanit;
- ➔ Instalimi i njehsorëve digjital për konsumatorët e sektori të amvisërisë;
- ➔ Faturimi i konsumatorëve banesorë bazuar në energjinë e shpenzuar;
- ➔ Intensifikimi i bashkëpunimit me organet komunale dhe qendrore.

## MASAT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË NDËRMARRJES

Me qëllim të realizimit të objektivave të saj gjatë vitit 2025, siç janë qëndrueshmëria financiare e ndërmarrjes, ofrimi i ngrohjes më kualitative për qytetarët, reformimi dhe modernizimi i administratës, rritja e arkëtimit përfshirë edhe borxhet, e tjera, janë paraparë këto masa:

- Ulja e mëtutjeshme e shpenzimeve operationale;
- Kompletimi i akteve të brendshme administrative;
- Rehabilitimi teknik i rrjetit të distribuimit dhe njësisë së prodhimit;
- Zbatimi i masave operationale për ngritjen e arkëtimit përfshirë edhe borxhet.

